



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • ëëë.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 5039 Prishtinë, Dt. 17/12/2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT
TE DIPLOMES MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Gjeografi/Gjeografi
Projekt-propozimi	Kuptimi i preferencave të destinacionit turistik të turistëve kosovar: një analizë lokale empirike (Understanding tourist destination preferences of Kosovan tourists: a local empirical analysis)
Kandidati	Qëndresa ZENELI
Mentori	Prof. Ass. Dr. Fitim HUMOLLI
Aprovimi i projekt propozimit	Datë: 03.07.2024
në Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.:2276; Vendimi për shtyrje: 2376,dt.14.07.2025

Pas punës fillestare, konsultative të kandidatës me udhëheqësin shkencor për temën master dhe vazhdimet të studimeve në terren të kandidatës, si dhe bazuar në kërkesën e kandidatës Qëndresa Zeneli të datës 16.12.2025 me nr. 5029, paraqesim këtë raport.

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT

Tema me titull **"Kuptimi i preferencave të destinacionit turistik të turistëve kosovar: një analizë lokale empirike"** e kandidatës Qëndresa Zeneli përbën studim të veçantë në gjeografinë humane përkatësisht në studimet gjeografiko turistike. Duke e vlerësuar si të munguar në tërësi problematikën e faktorëve dhe motive turistike, kandidatja së bashku me mentorin zgjodhën këtë çështje dhe temë dhe trajtim. Me këtë, ata synuan mbulimin e hendikepit mbi studime të tilla si dhe nevojat praktike për operatorët dhe qytetarët, mbi mundësitë e

përfitimeve nga alternativat e destinacioneve në të ardhmen. E tillë, në format dhe në shtrirje, tema vërtet merr kuptimin e një trajtесе tërësisht të munguar dhe mjaftë të nevojshme.

Tema trajton problematika studimore mjaft specifike. E analizuar mirë dhe me kujdes, mentori i temës së bashku me kandidaten kanë përzgjedhur mostër cilësore dhe të besueshme si mekanizëm kuantitativ metodologjik për arritjen e rezultateve. Me një mbulueshmëri të mirë hapësinore dhe me shtrirje në të gjitha grupmoshat me interes për turizëm, mostra rezulton të jetë e arsyeshme dhe mirë e konceptuar. Kjo duket mirë e menduar dhe mirë e trajtuar kur vlerësohen rezultatet e dorëzuara, si draft nga ana e kandidates.

Rezultatet e studimit mund të përfaqësojnë me besueshmëri, drejtimet kryesore të lëvizjeve së kosovarëve për qëllime turistike. Kandidatja ka hetuar metodologjikisht arsyet e përzgjedhjes së këtyre destinacioneve dhe i ka vënë në koorelim me një mori variablash. Ato, kësisoj tregojnë për motivet dhe faktorët që kategoritë e ndryshme shoqërore dhe grupet e ndryshme sociale, zgjedhin.

Duke hedhur një hipotezë mirë të menduar dhe të shoqëruar me pyetjet hulumtuese, të definuar qartë me qëllimin e studimit, objektivat e këtij punimi, gjithashtu të parashtruara në projekt propozim, u arritën dhe tanimë rezultatet dëshmuar këtë.

Problematikat e faktorëve social, mbyllja e madhe si mungesë e liberalizimit duke e theksuar me interes faktorin politik dhe të shoqëruar edhe nga mori faktorësh, përcaktojnë orientimin e theksuar të turistëve kosovar në drejtim të Shqipërisë dhe rajonit, në raport me destinacione tjera më pak të frekuentuara.

Rezultatet e studimit ofrojnë një bazë të fortë për zhvillimin e politikave turistike, strategjive të marketingut dhe ofrimin e produkteve turistike të përshtatura me preferencat reale të turistëve. Nga ana tjetër përmirësimi i infrastrukturës, diversifikimi i ofertës dhe promovimi efektiv mund të kontribuojnë në përafrimin e kërkesave të qytetarëve me ofertat operuese në vend.


Për këto arsye, një nismë e tillë studimore, tërësisht joshteruese është e pëlqyer dhe kurajuese për vijimin e studimeve tjera.

Kandidatja i ka qëndruar besnik formatit të punimit, sipas rregullores aktuale të studimeve master. Dorëshkrimi ka pasqyruar metodologji adekuate për natyrën e studimit, ndërsa korelacionet, mesataret, trendet, tabelat, hartat dhe veçmas grafikët, vetëm sa e kanë plotësuar punimin e studimit në fjalë.

PROPOZIM

Punimi i Diplomës më titull **“Kuptimi i preferencave të destinacionit turistik të turistëve kosovar: një analizë lokale empirike”** i kandidatës Qëndresa Zeneli, paraqet një kontribut të çmuar në studimet gjeografike në përgjithësi dhe gjeografiko-turistike në veçanti. Mbështetur në vlerësimin e punimit të kandidatës, një pjesë e të cilave janë shënuar sipëri, komisioni profesional/shkencor vlerëson se punimi i plotëson të gjitha kushtet formale, juridike dhe profesionale-shkencore për mbrojtje publike.

Prishtinë: 17.12.2025



Komisioni:

1. _____

Prof. Dr. Florim Isufi - Kryetar

2. _____

Prof. Ass. Dr. Fitim Humolli – anëtar (mentor)

3. _____

Prof. Asoc. Dr. Shpejtim Bulliqi - anëtar